Komunikojmë

Buletin tremujor mbi projektet për sistemin e drejtësisë në Shqipëri

TETOR – DHJETOR 2013 NUMRI 12

NË KËTË NUMËR:

VEPRIMTARITË NË TETOR – DHJETOR 2013

Simpozium mbi etikën gjyqësore 1

Vazhdon shtrirja e regjistrimit dixhital audio në gjykatat shqiptare 2

Ceremonia e hapjes së PAMECA IV 2

Seminar me gjyqtarë të gjykatës administrative 2

Plan veprimesh për menaxhimin aktiv të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë 2

Seminar për shkrimin e vendimeve gjyqësore 2

Diskutim mbi vlerësimin dhe inspektimin e gjyqtarëve 2

Hapësirë moderne për shërbimin dhe informimin e publikut në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë 2

Qasje rajonale për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit 3

Seminar mbi krimin e organizuar 3

Takim rajonal i Rrjetit të Qendrave për Zgjidhjen Alternative të Konflikteve 3

Fushatë e ndërgjegjësimit publik kundër korrupsionit 3

Trajnim i punonjësve të shërbimit të provës për trajtimin e të dënuarve për vepra penale në moshë të mitur 4

Klinika e Ligjit e FDUT-së 4

Forum mbi dhunën në familje 4

VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË JANAR – MARS 2014

NUMRAT E MËPARSHËM

Për t'i lexuar, klikoni ikonat e mëposhtme.

1 2 3 4 5 6 7 8 5 10 11

Të nderuar lexues,

Përgjatë më shumë se 100 ditëve në krye të Ministrisë së Drejtësisë kam qenë i përkushtuar maksimalisht në realizimin e një sfide të rëndësishme, sikurse është ndërtimi i një sistemi drejtësie të pavarur dhe të besueshëm, në bazë të Kushtetutës, në bazë të ligjit, në bazë të lirive dhe të drejtave themelore të qytetarit dhe në përmbushjen e ëndrrës së madhe për t'u integruar në familjen evropiane.

Sot, Ministria e Drejtësisë është e vendosur për të shënuar një faqe të re në sundimin e ligjit në Shqipëri, duke krijuar një vizion të ri e të qartë për një drejtësi që ofron siguri për çdo qytetar.

Reformimi, modernizimi dhe dixhitalizimi i sistemit të drejtësisë ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet tona dhe krahas tij, paralelisht, po hidhen me vendosmëri hapat për një luftë pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Përmes një programi të mbështetur në një vizion dhe politika të reja, shpreh bindjen time në realizimin e sfidave të përbashkëta në sistemin e drejtësisë.

Së fundi, gjej rastin të falënderoj të gjithë donatorët dhe bashkëpunëtorët për realizimin e të gjitha projekteve, si dhe të shpreh angazhimin maksimal të Ministrisë së Drejtësisë për të përçuar më tej vullnetin dhe objektivat politike për një qeverisje transparente, efiçente dhe të përgjegjshme.

Arritjet e mëdha kërkojnë ambicie të mëdha!

Sinqerisht,

Nasip Naço
Ministër i Drejtësisë

VEPRIMTARITË NË TETOR – DHJETOR 2013

Simpozium mbi etikën gjyqësore

OPDAT Shqipëri, në partneritet me Konferencën Kombëtare Gjyqësore dhe Unionin e Gjyqtarëve të Shqipërisë (UGJSH), organizoi në 5 - 7 nëntor 2013 Simpoziumin mbi Etikën Gjyqësore, si një forum ku gjyqtarët nga të tria shkallët e gjyqësorit të mund të diskutonin mbi standardet dhe dilemat aktuale për etikën, perceptimin e gjyqësorit nga publiku, mënyrat se si mund të bëhen të detyrueshme rregullat për etikën dhe të shkarkohen gjyqtarët e korruptuar dhe pa etikë. Për të drejtuar debatin dhe ofruar një perspektivë të ndryshme, OPDAT ftoi Gjyqtarin Richard Berman të Gjykatës së Distriktit Jugor të Nju Jorkut, SHBA, ndërsa UGJSH ftoi Z. Gerhard Reissner, Kryetar i Gjykatës së Distriktit Florisdorf në Vjenë dhe President i Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve. Në simpozium morën pjesë gjyqtarë nga Gjykata e Lartë dhe gjykatat e

Seanca e hapjes së Simpoziumit treditor mbi etikën gjyqësore, Tiranë, 5 nëntor 2013.

rrethit dhe apelit, inspektorë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, profesorë të Shkollës së Magjistraturës, këshilltarë të Presidentit të Republikës, etj. Ambasadori i SHBA-së, Z. Alexander Arvizu dhe Presidenti i Republikës, Z. Bujar Nishani, Kryetar i KLD-së, përshëndetën të pranishmit në hapje të simpoziumit. Si Ambasadori Arvizu dhe Presidenti Nishani theksuan nevojën që gjyqtarët të tregohen me kurajë për t'i bërë ballë presionit dhe për të çrrënjosur gjyqtarët e korruptuar dhe pa etikë nga radhët e tyre. Në mbyllje të simpoziumit, pjesëmarrësit miratuan konkluzione që do t'u dërgohen të gjithë aktorëve në sistemin e drejtësisë dhe do të shërbejnë si udhëzues për veprimtaritë e ardhshme të OPDAT-it. Mes të tjerave, ata ranë dakord për domosdoshmërinë e ndërmarrjes së hapave specifike legjislative për t'i bërë rregullat mbi etikën të detyrueshme dhe për ta kthyer performancën etike në një prej faktorëve për t'u marrë në konsideratë për transferimet apo ngritjet në detyrë. Ata gjithashtu shprehën kërkesën për më shumë trajnime mbi temat e etikës gjyqësore, duke mbrojtur idenë që ato të bëhen të detyrueshme dhe një kërkesë për të ecur në karrierë.

Vazhdon shtrirja e regjistrimit dixhital audio në gjykatat shqiptare

Me mbështetjen e projektit JuST të USAID-it, deri në fund të dhjetorit 2013, teknologjia e regjistrimit dixhital audio (RDA) ishte instaluar në 23 gjykata në Shqipëri, duke e çuar në 107 numrin e sallave të gjyqit me mundësi për regjistrimin audio të seancave gjyqësore. Sipas ligjit, tani procesverbali i plotë i seancave gjyqësore është ai audio dhe teknologjia RDA ka ndikuar pozitivisht në punën e gjykatave. Ky ishte mesazhi i përcjellë nga gjyqtarët dhe personeli administrativ i 6-të gjykatave në rajonin e apelit Tiranë si dhe i atyre për Krime të Rënda, të cilët morën pjesë në Konferencën e 3-të Rajonale të Lidershipit në Gjyqësor për përdorimin e teknologjisë RDA që u zhvillua në Tiranë, në 13 - 15 nëntor 2013. Ndërkohë, puna për shtrirjen e mëtejshme të sistemit RDA vazhdon në dy rajonet e fundit të apelit, Gjirokastër dhe Shkodër.

Seminar me gjyqtarë të gjykatës administrative

Më 21 dhe 22 nëntor, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Shkolla e Magjistraturës organizuan një seminar për gjyqtarët e gjykatës administrative mbi zbatimin e sistemit të drejtësisë administrative në Shqipëri. Gjykatat administrative filluan të funksionojnë më 4 nëntor 2013 dhe qëllimi i këtij seminari ishte t'u ofronte gjyqtarëve të sapoemëruar një mundësi për të njohur më mirë elementet e rinj procedurale të parashikuar në Ligjin për Gjykatat Administrative. Prezenca ndihmoi në hartimin e këtij ligji në vitin 2012 dhe do të vazhdojë të mbështesë kalimin në një sistem të specializuar të drejtësisë administrative me rregulla procedurale unike.

Diskutim mbi vlerësimin dhe inspektimin e gjyqtarëve

Me mbështetjen e projektit JuST, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë realizoi dy seminare me temë "Sistemi i Vlerësimit dhe Inspektimit të Gjyqtarëve në Shqipëri: Përafrimi me Standardet Ndërkombëtare". Nga gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë, Elbasan, Durrës, Lushnjë, Kavajë dhe Krujë, si dhe nga gjykatat për Krime të Rënda, 33 gjyqtarë u përfshinë aktivisht në diskutime lidhur me sistemin e vlerësimit të etikës dhe profesionalizmit në gjyqësor, si dhe rregulloren për inspektimet nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Konkluzionet dhe rekomandimet e këtyre takimeve u përmblodhën në një raport që iu vu në dispozicion të gjithë anëtarëve të UGJSH-së dhe institucioneve përkatëse.

Ceremonia e hapjes së PAMECA IV

Ceremonia e hapjes së projektit PAMECA IV u mbajt më 11 dhjetor 2013. Në të morën pjesë SH.T.Z. Ambasador Ettore Sequi, Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, SH.T.Z. Saimir Tahiri, Ministër i Punëve të Brendshme, Prefekt Alessandro Pansa, Shef i Policisë së Shtetit Italian, Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit të Sigurisë Publike, Z. Artan Didi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Z. Adnan Xholi, Drejtor i Hetimit dhe Kontrollit të veprave të tjera dhe të Miturve, në emër të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe shumë aktorë të tjerë. Në vijim të ceremonisë u mbajt Takimi i Parë i Komitetit të Palëve të Interesuara, i bashkëkryesuar nga PAMECA IV, Prokuroria e Përgjithshme dhe Policia e Shtetit Shqiptar. PAMECA IV është një projekt i asistencës teknike i financuar nga BE-ja, që do të mbështesë dhe ndihmojë institucionet shqiptare ligjzbatuese, në veçanti Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Ai është i organizuar në pesë fusha veprimtarish: 1) Struktura, Organizimi, Burimet Njerëzore, Logjistika, Buxheti në Policinë e Shtetit Shqiptar; 2) Hetimet ndaj Krimit të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe Korrupsionit; 3) Të Drejtat e Njeriut dhe Policimi në Komunitet; 4) Patrulla e Përgjithshme dhe Policia Rrugore; 5) Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK).

Ceremonia e hapjes së projektit PAMECA IV, Tiranë, 11 dhjetor 2013.

Plan veprimesh për menaxhimin aktiv të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë

Projekti JuST i USAID-it dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri vijuan angazhimin e tyre me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila është e vendosur të ndryshojë praktikat e menaxhimit të çështjeve gjyqësore që shkaktojnë zhvillimin e seancave joproduktive, humbje kohe dhe vonesa të panevojshme. Kështu, me të gjashtë gjyqtaret dhe kancelarin e kësaj gjykate u organizua në dhjetor një tryezë dyditore. Diskutimi u drejtua nga Gjyqtari Truman A. Morrison i Gjykatës Superiore të Distriktit të Kolumbias, SHBA. Gjyqtarët u përqendruan te hapat praktikë që mund të merren për t'i bërë seancat gjyqësore të efektshme dhe efikase. Në përfundim të diskutimeve, grupi i punës ra dakord për përcaktimin e disa objektivave specifike e të matshme, si dhe për pikat e një plani veprimesh që do të sjellin përmirësime në dhënien e drejtësisë.

Seminar për shkrimin e vendimeve gjyqësore

Në 10 - 11 dhjetor 2013, OPDAT Shqipëri organizoi seminarin për shkrimin e vendimeve gjyqësore ku morën pjesë 31 pjesëmarrës duke përfshirë gjyqtarë të shkallës së parë dhe apelit, ndihmës ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe të Apelit si dhe studentë të Shkollës së Magjistraturës. Seminarin e drejtuan Gjyqtarja Consuelo Callahan e Gjykatës së Apelit për Cirkuitin e 9-të në SHBA dhe Richard Schickele, ndihmësi i saj ligjor i karrierës. Disa nga çështjet që u diskutuan ishin: përgatitja për të shkruar, organizimi dhe shkrimi i një vendimi, vetë-redaktimi dhe redaktimi gjuhësor, etj. Pati dhe një sesion që iu dedikua çështjeve të etikës në shkrimin e vendimeve me gjyqtarë të tjerë si dhe diskutimit mbi një vendim gjyqi shqiptar të zgjedhur rastësisht. Pjesëmarrësit e mirëpritën seminarin dhe morën pjesë aktive në diskutime.

Hapësirë moderne për shërbimin dhe informimin e publikut në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë

Në 22 nëntor 2013, Drejtori i Misionit të USAID-it në Shqipëri, Jim Barnhart dhe Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Entela Shedula, përuruan hapësirën e re të shërbimit dhe informimit të publikut, të ngritur me mbështetjen e projektit JuST. Falë rikonstruksionit të kryer, kjo gjykatë ka tashmë një hapësirë moderne ku qytetarët mund të marrin shërbimet dhe informacionin që kanë nevojë në mënyrë transparente dhe të standardizuar, ndërkohë që personeli përgjegjës kryen punën e tij me më shumë lehtësi dhe efikasitet. Gjykata e Kavajës është e dyta ku USAID-i ka mbështetur modernizimin e hapësirës së shërbimit dhe informimit publik. E para ishte ajo e Pogradecit dhe ndërkohë po punohet për një projekt të tretë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, JuST synon që përmes kësaj përpjekjeje të ndihmojë në detajimin dhe konsolidimin e standardeve për hapësirat për shërbimin dhe informimin e publikut në gjykatat shqiptare.

Qasje rajonale për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe rritjen e bashkëpunimit mes vendeve të rajonit, projekti "Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve", i financuar nga BE IPA 2010 dhe i zbatuar nga GIZ dhe Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC), organizoi tri trajnime të tjera rajonale dhe tri vizita studimore për prokurorët e Ballkanit Perëndimor. Trajnimi rajonal për mbledhjen e provave në rastin e veprave penale ndërkufitare u organizua në Cavtat, Kroaci, ai për hetimin financiar në Lubljanë, Slloveni, ndërsa i treti, për Ekipet e Përbashkëta të Hetimit, në Danilovgrad, Mal i Zi. Vizitat studimore u organizuan pranë zyrave të prokurorive në Zvicër, Gjermani e Itali dhe të gjitha u fokusuan te hetimi financiar. Për të forcuar bashkëpunimin e përfituesve të projektit me homologët evropianë, projekti mundësoi praninë e dy përfaqësuesve të Rrjetit të Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor, nga Shqipëria dhe Maqedonia, në takimin e Rrjetit Gjyqësor Evropian (EJN) në Vilnius, Lituani, për të biseduar mbi mënyra të tjera më efikase të bashkëpunimit. Lidhur me kuadrin ligjor për ndihmën e ndërsjellë juridike në vendet përfituese, projekti ka ndërmarrë një vlerësim të legjislacionit në to, me qëllim që të analizojë se në ç'masë këto ligje e lehtësojnë ose pengojnë ndihmën e ndërsjellë dhe në vijim të hartojë rekomandimet e nevojshme për përmirësim. Gjithashtu, gjatë tremujorit të fundit të 2013-ës, projekti ka përparuar në vendosjen e kanaleve të sigurta të komunikimit mes prokurorive në vendet përfituese. Në kuadër të këtij aktiviteti do të instalohen pajisje të ndryshme komunikimi në zyrat e prokurorive që do t'iu mundësojnë atyre komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit në mënyrë të sigurt.

Seminar mbi krimin e organizuar

Më 19 - 21 nëntor 2013, OPDAT Shqipëri organizoi një Seminar për Krimin e Organizuar (KO) me pjesëmarrjen e Zv.Drejtuesit të Seksionit për KO-në Ndërkombëtare dhe Bandat e Armatosura në Departamentin e Drejtësisë, Z. Thomas Ott, Prokurorin për Çështjet e Organizatave të Korruptuara dhe me Influenca Kriminale, Z. Robert Dalton dhe Agjenten Speciale Supervizore të Njësisë së Operacioneve kundër KO-së Transnacionale Ballkaniko-Euroaziatike në FBI, Znj. Jennifer Turner. Një ekspert i ICITAP-it, një prokuror italian dhe 6 ekspertë shqiptarë për KO-në u përfshinë gjithashtu në seminar. Përfituesit ishin rreth 25 prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, gjyqtarë dhe oficerë policie nga Policia e Shtetit që punojnë me Prokurorinë dhe Gjykatën për Krime të Rënda për çështje të KO-së. Temat e seminarit përfshinë historikun e KO-së në SHBA dhe Shqipëri; një përmbledhje të situatës aktuale të KO-së shqiptare në Shqipëri, Evropë dhe SHBA; një përmbledhje të kuadrit ligjor të Shqipërisë dhe SHBA-së për KO-në; mjetet procedurale në duart e forcave të zbatimit të ligjit në luftën kundër KO-së transnacionale (përdorimi i bashkëpunëtorëve, marrëveshjeve paragjyqësore dhe atyre të bashkëpunimit), si dhe një prezantim mbi kuadrin ligjor për sekuestrimet e konfiskimet civile dhe vënien e tij në zbatim. Ky seminar shënoi fillimin e një serie trajnimesh më specifike që do të zhvillohen gjatë 2014-ës për përdorimin e bashkëpunëtorëve, hetimet financiare, pastrimin e parave, hetimin e krimeve kompjuterike dhe sekuestrimet/konfiskimet civile.

Takim rajonal i Rrjetit të Qendrave për Zgjidhjen Alternative të Konflikteve

Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, GIZ, në kuadër të projektit të Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Reforma Ligjore (ORF-LR) mblodhi drejtuesit e qendrave për Zgjidhjen Alternative të Konflikteve (ADR) të Ballkanit Perëndimor në një tryezë të rrumbullakët në 15 nëntor 2013, në Budva, Mal i Zi, për të prezantuar projektin e ri "Zbatimi i mjeteve ADR i orientuar nga barazia gjinore në Ballkanin Perëndimor". Këto qendra përfshinë Gjykatën e Arbitrazhit pranë Dhomës

Takimi rajonal i GIZ ORF-LR për projektin ADR, Budva, Mal i Zi, 15 nëntor 2013.

së Tregtisë së Jashtme, Bosnje - Hercegovinë, Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit pranë Dhomës së Ekonomisë së Kroacisë, Qendrën e Ndërmjetësimit pranë Dhomës së Ekonomisë së Kroacisë, Tribunalin e Përhershëm të Arbitrazhit në Kosovë, Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit pranë Dhomës së Ekonomisë së Maqedonisë, Arbitrazhin e Tregtisë së Jashtme dhe Gjykatën e Përhershme pranë Dhomës së Ekonomisë së Malit të Zi dhe Gjykatën e Arbitrazhit për Tregtinë e Jashtme pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Serbisë. Në këtë mbledhje morën pjesë edhe partnerë ndërkombëtarë, si DIS (Instituti Gjerman për Arbitrazhin) dhe Sekretariati i UNCITRAL-it. Gjatë takimit, qendrat shkëmbyen informacion mbi zhvillimet më të fundit në fushën e arbitrazhit në vendet përkatëse, rregullat e arbitrazhit në qendrat e tyre, statistikat për çështjet e arbitrazhit, si dhe të dhënat mbi arbitrat dhe personelin e qendrave sipas gjinisë që është dhe fokusi qendror i projektit. Në tryezën e rrumbullakët u vendos që rrjetit ekzistues, i cili ka aktualisht 9 anëtarë, duke përfshirë dhe Qendrën Shqiptare të Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregtar, mund t'i bashkohen dhe organizata të ngjashme nga shtete të tjera.

Fushatë e ndërgjegjësimit publik kundër korrupsionit

Me mbështetjen e OPDAT-it, Prokuroria e Përgjithshme ndërmori një fushatë që synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut përsa i përket ndikimit negativ të korrupsionit, të forcojë rezistencën kulturore ndaj fenomenit të mitmarrjes dhe të nxisë denoncimin e krimeve të korrupsionit. Fushata filloi më 9 dhjetor, Dita Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, me prezantime të prokurorëve për luftën kundër korrupsionit në 12 shkolla të mesme publike në Shkodër, Durrës, Fier, Korçë dhe Gjirokastër. Nxënësit u ftuan të marrin pjesë në një konkurs për krijimin e posterave kundër korrupsionit. Posterat fitues do të ekspozohen në Galerinë Kombëtare të Arteve në fund të marsit 2014 dhe në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të Ambasadës së SHBA-së në internet, si dhe do të përdoren për reklama në median e shkruar. Është planifikuar që pas fushatës me postera të vijohet me filmimin e videove me temë antikorrupsionin që do të përdoren për reklama në televizion, si dhe me një aktivitet të madh në Tiranë. OPDAT-i ka sponsorizuar dhe prodhimin e 10.000 byzylykëve prej gome me mesazhin e fushatës "Kundërshtoj Korrupsionin" që do t'u shpërndahen nxënësve të shkollave, etj. Shkollat e mesme publike në Korçë i kanë marrë dhe shpërndarë këta byzylykë, tashmë. Prokurorët për këtë fushatë po përdorin edhe një logo me të njëjtin mesazh. Ministria e Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe shkollat e mesme publike në 7 qytetet ku funksionojnë Njësitë e Përbashkëta të Hetimit Antikorrupsion, e kanë përqafuar fushatën dhe kanë dhënë mbështetje logjistike.

KUNDËRSHTOJ KORRUPSIONIN

Logoja e fushatës kundër korrupsionit.

Trajnim i punonjësve të shërbimit të provës për trajtimin e të dënuarve për vepra penale në moshë të mitur

Nga 20 deri më 22 nëntor 2013, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi një trajnim për 20 punonjës të shërbimit të provës që u fokusua në përmirësimin e aftësive në punën me të dënuarit e mitur për rritjen e mundësive të tyre për t'u ri-integruar në shoqëri. Punonjësit e shërbimit të provës studiuan praktika efikase për trajtimin e të dënuarve në komunitet, duke mësuar se si mund të hartojnë programe trajtimi që mbështeten te vlerësimi i rreziqeve dhe nevojave. Trajnimi u organizua si pjesë e projektit të Prezencës për zhvillimin e praktikave efikase të shërbimit të provës në Shqipëri. Me kalimin e viteve, Shërbimi i Provës ka qenë i suksesshëm në reduktimin e kostove dhe pasojave negative të burgimit, ndërkohë që në raport me të dënuarit për vepra penale në moshë të mitur, ata të vendosur në provë kanë ardhur në rritje.

Punonjës të Shërbimit të Provës në përfundim të trajnimit, 22 nëntor 2013.

Forum mbi dhunën në familje

Më 2 dhjetor, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi të parin e një serie forumesh për studentët e shkollave të mesme dhe të larta për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre lidhur me dhunën në familje dhe mekanizmat ligjorë të mbrojtjes prej saj. Ky forum i parë, i organizuar bashkë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si dhe atë të Arsimit dhe Sportit, u mbajt me studentë të shkencave sociale në Universitetin e Tiranës. Këto forume synojnë të ndryshojnë mentalitetin dhe sjelljen e të rinjve në lidhje me dhunën në familje, që ende është e përhapur në Shqipëri, si dhe të rrisin njohuritë për mekanizmat ligjorë për parandalimin dhe dhënien fund të saj.

Klinika e Ligjit e FDUT-së

Projekti JuST i USAID-it përfundoi ngritjen e laboratorit të studentëve dhe të zyrës së pritjes së klientëve për Klinikën e Ligjit në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës (FDUT). Po kështu u ngrit dhe një sallë e gjyqit imitues. Pas miratimit të rregullores së Klinikës, JuST ndihmoi në përgatitjen e formularëve të nevojshëm për t'u përdorur në procesin e dhënies së ndihmës. Projekti gjithashtu prodhoi materiale informative mbi Klinikën, si për klientët që mund të marrin ndihmë ligjore falas, ashtu dhe studentët. Synimi i programit të edukimit klinik ligjor në FDUT është që të ndihmojë studentët në zhvillimin e mendimit kritik ligjor dhe të aftësive praktike, si dhe t'i angazhojë ata drejtpërdrejt, nën mbikëqyrjen e duhur, në dhënien e shërbimeve ligjore për klientët në nevojë.

VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË JANAR – MARS 2014

- Seminar kombëtar për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, Hotel "Sheraton", Tiranë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Ministria e Punëve të Brendshme, 23 janar 2014
- Tryezë e rrumbullakët me Njësitë e Përbashkëta të Hetimit dhe vizita në terren, OPDAT Shqipëri, janar 2014
- Tryezë e rrumbullakët me avokatë mbrojtës në lidhje me çështje të shërbimit të provës, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, janar 2014
- Botimi i numrit të 9-të të revistës juridike "Avokatia", Dhoma Kombëtare e Avokatisë, me mbështetjen e USAID JuST, janar 2014
- Seminar për KO-në "Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe përdorimi i bashkëpunëtorëve", OPDAT Shqipëri, 11 - 12 shkurt 2014
- Seminar kombëtar mbi antitrafikimin, OPDAT Shqipëri, 24 - 25 shkurt 2014
- Konferenca Rajonale e Lidershipit në Gjyqësor mbi përdorimin e sistemit të regjistrimit dixhital audio (RDA) me pesë gjykatat e rajonit të apelit Vlorë, USAID JuST, 27 shkurt 2014
- Seminar rajonal mbi antitrafikimin në Ballkan, OPDAT Shqipëri, 27 - 28 shkurt 2014
- Trajnim për përgatitjen e reportazheve për anëtarët e Shoqatës së Gazetarëve për Drejtësi (SHGD), USAID JuST, shkurt 2014
- Përfundimi i vitit të dytë të kurseve të Arsimimit Vazhdues Ligjor për avokatët dhe asistent-avokatët në Vlorë dhe Durrës, organizuar nga USAID JuST në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe dy dhomat rajonale, shkurt 2014
- Shtrirja e teknologjisë RDA në gjykatat e rretheve gjyqësore Gjirokastër dhe Përmet, USAID JuST, shkurt - mars 2014
- Tryezë e rrumbullakët mbi etikën gjyqësore - Gjykata e Lartë, OPDAT Shqipëri, 10 mars 2014
- Trajnim mbi etikën gjyqësore - Gjykatat e apelit, Gjykatat e shkallës së parë, OPDAT Shqipëri, 12 mars, 14 mars 2014
- Seminar për krimin e organizuar "Hetimet financiare dhe konfiskimi i aseteve", OPDAT Shqipëri, 26 - 27 mars 2014
- Aktivitetet përmbyllëse të projektit, BE IPA 2010 "Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve", janar - mars 2014

USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE
USAID JuST
E-mail: office@ajssp.org.al
www.usaid.gov

osce Organization for Security and Co-operation in Europe Presence in Albania
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
E-mail: pm-al@osce.org
www.osce.org/albania

OPDAT-Albania
E-mail: VaccaroMR@state.gov
www.justice.gov/criminal/opdat

PAMECA IV
E-mail: info@pameca.org.al
www.pameca.org.al

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
GIZ ORF-LR
E-mail: christian.athenstaedt@giz.de
www.giz.de

Fight Against Organised Crime and Corruption, Strengthening the Prosecutors' Network
E-mail: orflex-al@giz.de
www.giz.de

Shprehjet e falënderimit dhe mbi përgjegjësitë

Artikujt e këtij buletini janë kontribute të projekteve të donatorëve të cilët mbështesin aktivisht reformën në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Kontribuuesit mbajnë përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e artikujve të tyre, të cilat nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve apo qeverive përkatëse.